

IMPAKTI I COVID-19 NË IHD

PËRMBAJTJA:

1 PARASHIKIMET FILLESTARE RRETH IMPAKTIT TË COVID-19 MBI IHD

2 VLA E DYTË E PANDEMISË DHE SITUATA AKTUALE NË IHD

3 INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI


4 KONKLUSIONE

1


PARASHIKIMET FILLESTARE RRETH IMPAKTIT TË COVID-19 MBI IHD

Që në fillimet e pandemisë COVID-19, ishte e qartë se bota nuk po përballej vetëm me një emergjencë shëndetësore, por me një fenomen që do kishte ndikim të ndjeshëm në ekonominë globale.

Për këtë arsye u realizuan studime dhe u hartuan raporte të ndryshme me qëllim analizimin e situates aktuale, parashikimin e dëmit të shkaktuar, evidentimin e ndikimit të pandemisë në investimet globale, si dhe hartimin e skenareve të mundshme të rimëkëmbjes së ekonomisë.



- Sipas raportit të **UNCTAD**, publikuar më 8 mars 2020, parashikohej se pandemia COVID-19 mund të shkaktojë rënie në flukset globale të investimeve të huaja direkte duke zbritur në nivelet më të ulëta që nga kriza financiare e vitit 2008.
- Sipas këtij raporti, fillimisht parashikohej një rënie globale e IHD-ve rreth 5% - 15% krahasuar me periudhat e mëparshme.
- Sipas një raporti të mëvonshëm nga UNCTAD, publikuar në Maj 2020, kjo rënie e vlerës totale të IHD-ve në rang global për vitin 2020 rivlerësohet mes 30% dhe 40% krahasuar me vitet e mëparshme.



Burimi: UNCTAD, World Investment Report 2020

Nga ana tjetër, firma këshilluese për investime të huaja **WAVTEQ** realizoi në Mars 2020 një studim lidhur me ndikimin e COVID-19 mbi nivelin global të IHD-ve, e cila paraqitet grafikisht më poshtë. Studimi bazohet në të dhënat paraprake të FDI Markets dhe nuk përfshin të gjitha projektet e IHD, por përfshin shumicën e investimeve kryesore.

Duke iu referuar grafikës së mëposhtme, dallohet një rënie të dukshme e këtyre projekteve deri në 20% për vitin 2020.



Burimi:
WAVTEQ

Gjithashtu, **WAVTEQ** analizoi ndikimin e COVID-19 mbi nivelin e IHD-ve sipas rajoneve të caktuara, e cila paraqitet grafikisht më poshtë.


Vihet re është se rënia më e madhe parashikohej në rajonin e Europës Perëndimore me përkatësisht 26%, ndërsa në vendet në zhvillim kjo rënie parashikohej në vlerën 12%.



Burimi: WAVTEQ

SKENARET E RIMËKËMBJES

Shfaqen pasiguri në skenaret e mundshme të ndikimit të COVID-19 në ekonomitë botërore dhe në skenaret e rimëkëmbjes. Grafikisht, skenaret e parashikuara të rimëkëmbjes sipas analizës së **IBM-Plant Location International** në Qershor 2020, paraqiten si më poshtë.



Burimi: IBM, Plant Location International

Megjithatë sipas **S&P Global**, aktualisht parashikohet një skenar ndryshe, i ashtuquajtur skenari i rimëkëmbjes Formë K. Sipas këtij skenari, rritja do të jetë e vazhdueshme, por e pabarabartë. Ajo diferencohet sipas sektorëve dhe grupeve të të ardhurave.

NDIKIMI MBI IHD SIPAS SEKTORËVE

FDI Intelligence së bashku me **WAVTEQ** identifikoi në Mars 2020 impaktin global të COVID-19 sipas sektorëve ekonomikë, duke parashikuar sektorët që do përjetonin rritje, rënie të lehta, apo rënie të ndjeshme të IHD-ve në nivel global.

RËNIE E NDJESHME E IHD-ve

- Turizmi
- Argëtimi
- Tregtia me pakicë
- Produktet e luksit
- Aviacioni
- Pasuritë e paluajtshme
- Qymyri, nafta dhe gazi

RËNIE E LEHTË E IHD-ve

- Agrobiznesi
- ICT
- Industria Automotive
- Transporti
- Produktet farmaceutike
- Pajisjet mjekësore
- Shërbimet financiare

RRITJE E IHD-ve

- eCommerce
- Teknologjia Digjitale
- Siguria kibernetike
- Bioteknologjia
- Shëndetësia
- Kërkim dhe Zhvillim (R&D)
- Energjia e Rinovueshme


Burimi: WAVTEQ, FDI Intelligence

2

VALA E DYTË E PANDEMISË DHE SITUATA AKTUALE NË IHD

- Gjysma e parë e vitit 2020, pati një rënie prej 49% në flukset e IHD-ve.
- Njoftimet e projekteve të reja bien 37%.
- Perspektivë negative.
- Ekonomitë e zhvilluara patën një rënie prej 75% në flukset e IHD-ve në gjysmën e parë të vitit 2020 .
- IHD-të në ekonomitë në zhvillim kanë rënë me 16%, më pak sesa pritej.

Termometrat globalë të investimeve, 2020 T1 – T3



Burimi: UNCTAD

* Trendi i projekteve greenfield i referohet 8 muajve të pare të 2020.

** Financimi i projekteve ndërkombëtare i referohet (trendit të) numrit të marrëveshjeve, pasi vlerat e projekteve për muajt e fundit janë të padisponueshme.

SITUATA AKTUALE NË IHD: PASIGURIA VAZHDON

- Flukset drejt Evropës gjatë gjysmës së parë të vitit 2020 ishin negative në -7 miliardë dollarë kryesisht për shkak të faktit se shtete si Holanda dhe Zvicra rezultojnë me bilanc negativ.
- Sidoqoftë, shpalljet e projekteve greenfield dhe projektet e financimit ndërkufitar ranë me vetëm 17%, ndërsa Bashkimet dhe Blerjet (M&As) me 5%.
- Vendet evropiane që regjistruan rritje të IHD ishin Irlanda dhe Gjermania.
- Projektet greenfield në manifakturë panë rëniet më të mëdha me një nivel prej 46% në numrin e projekteve, ndërsa shërbimet panë rënien më të vogël prej 29%.
- Nëse vala e dytë e pandemisë ndikon në ekonominë e zhvilluara, është e mundur që flukset e IHD-ve të bien më afër rënies aktuale të 50%.

Burimi: UNCTAD Investment Monitor, 27 October, 2020




INVESTIMET E SHPALLURA NË WB6 GJATË MARS-GUSHT 2020

- 30 projekte u shpallën midis marsit dhe gushtit 2020.
- Të gjitha ekonomitë e WB6 regjistruan të paktën 1 shpallje projekti gjatë kësaj periudhe.

Numri i projekteve për WB6, Mars-Gusht 2020



Numri i projekteve në botë, Mars-Gusht 2020



Burimi: FDI Markets, FT


NDIKIMI SEKTORIAL SIPAS SHTETEVE: Hartat e nxehtësisë të sektorëve COVID-19 të Deloitte (shtator 2020)



- 1 High impact on businesses trading & cash flows
- 2 Significant disruption, likely financial impact loss
- 3 Neutral or low impact / loss
- 4 Positive Outlook

Burimi: Deloitte, COVID-19 sector heatmaps, June 2020
<https://www2.deloitte.com/global/en/pages/about-deloitte/articles/covid-19/covid-19-sector-map.html>


IHD - Fluksi / mln EUR



Burimi: Banka e Shqipërisë

- Fluksi i IHD-ve tejkaloi 1 miliard euro në fund të vitit 2019.
- Për vitin 2019, burimi kryesor i fluksit të IHD-ve ishte Sektori i Energjisë që përfaqësonte 31% të fluksit total të IHD-ve.
- Fluksi i IHD-ve për tremujorin e dytë të vitit 2020 ishte 221 mln EURO, duke rënë me gati 11% krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019, kryesisht për shkak të pasojave të pandemisë Covid19.
- Investimet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 ishin përqendruar kryesisht në sektorin e energjisë (40.7%), Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimeve (22.1%), Industrinë e Përpunimit (8.1%) dhe TIK (7.6%).

FLUKSI JANAR-QERSHOR 2020




- Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, për periudhën Janar – Qershor 2020, indikator i fluksit shënon vlerën €454 milionë.
- Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur fluksi shënonte € 546 milionë, vihet re një ulje me rreth 17%.

Burimi: Banka e Shqipërisë

STOKU I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

IHD - Stoku / mln EUR



Burimi: Banka e Shqipërisë



Stoku i IHD-ve arriti një vlerë prej 8.5 miliardë Euro në fund të vitit 2019, duke u rritur me 12.4% krahasuar me 2018.



Stoku i IHD-ve arriti një vlerë prej 8,419 milion Euro në tremujorin e dytë të vitit 2020, duke u rritur me 6.2% nga tremujori i parë i vitit 2020 dhe me 8.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

- Në një analizë të botuar më 4 maj 2020, UNCTAD rishikoi parashikimet fillestare mbi ndikimin e mundshëm të pandemisë COVID19 në nivelin e IHD-ve dhe zinxhirët globalë të furnizimit. Sipas parashikimit të ri pritet një rënie e IHD-ve globale të vlerësuara në masën -30% në -40% edhe në vijim të 2021, shumë më tepër sesa parashikimi i tyre fillestar prej -5% në 15% nga fillimi i marsit (UNCTAD, 2020).
- Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, rënia e fluksit të investimeve të huaja direkte në Shqipëri ka qenë në nivelin 11%, brenda parashikimit fillestar të realizuar nga UNCTAD.
- Sidoqoftë, duke patur parasysh masat e vazhdueshme që po ndërmerren për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të pandemisë, është e pritshme një rënie e nivelit të IHD-ve edhe përtej nivelit 11%, siç parashikohet nga UNCTAD në raportin e rishikuar të efektit të IHD-ve në nivel global.